

Osmani i drejtohet  
Kushtetueses, kërkon sqarime  
për pasojat juridike të moskon-  
stituimit të Kuvendit | FAQE 10



Na ndiqni edhe në:

[www.epokaere.com](http://www.epokaere.com)



facebook.com  
Gazeta "Epoka e re"



**ABBRUCH** GMBH  
[www.awr-abbruch.de](http://www.awr-abbruch.de)

NË HAGË MBAHET KONFERENCA STATUSORE PËR RASTIN NDAJ LIDERËVE TË UÇK-së

## AVOKATI I THAÇIT GODET GJYQTARËT E SËPECIALES: S'PO NA JEPNI AFAT TA PËRGATITIM MBROJTJEN

FAQE 4-5



Avokati i Hashim Thaçit, Lluka Misiqi, është ankuar se trupi gjykes ka refuzuar kërkesën prej 10 javësh që mbrojtja ta përgatisë çështjen e saj, duke thënë se më 25 gusht mbrojtja duhet ta nisë

rastin. "Gjykata ka ulur kohën për përgatitjen e mbrojtjes nga 10 javë në 2 javë", ka thënë ai, duke shtuar se ky afat është barrë e madhe për ekipin e tij. Ai ka thënë se trupi gjykes ka

vendosur për disa afate të kërkuara nga ZPS-ja pa dëgjuar parashtrimet e mbrojtjes. Ai i ka pyetur gjyqtarët se kur e kanë trajtuar ZPS-në sikurse mbrojtjen e liderëve të UÇK-së

**SHËRBIMET  
KROATE:  
PËRSHKALLËZIMI  
I TENSIONEVE  
NË KOSOVË,  
RREZIK I  
VAZHDUESHËM** F. 6



**BILDT: BLOKADA  
POLITIKE KA  
DËMTUAR  
BESUESHMËRINË  
E SHTETIT TË  
KOSOVËS, KJO  
ËSHTË KEQ PËR  
TË GJITHË** F. 3



**MUNGOJNË FATURAT, SHOQATA E  
PRODHUESVE KËRKON PEZULLIMIN  
E VENDIMIT TË ZRRË-SË PËR  
TARIFAT E REJA TË ENERGJISË** F. 8

**INSPEKTORATI: KOMPANIA  
KU NDODHI AKSIDENTI NË  
GJAKOVË ISHTË GJOBITUR  
DY HERË PËR SHKELJE** F. 8

**SPORT**



**XHAKA I THOTË 'PO' SUNDERLANDIT,  
PRITET MIRATIMI I LEVERKUSENIT** F. 10

**RENOVA**  
PUTZ  
Magedoni  
Xhepçisht - Tetovë  
Gurëz-Ferizaj  
Tel: +389 44 487 300; +389 44 487 009  
+389 44 487 755  
Fax: +389 44 487 200  
Mob: +377 44 501 289  
E-mail: [renova@ml.net.mk](mailto:renova@ml.net.mk)

**PRINCESHA**  
GROUP SH.P.K.  
NDËRTIM  
PROJEKTIM  
SHITJE  
INFO: 049-111-101,  
044-511-177  
[www.princesha-ks.com](http://www.princesha-ks.com)

**Bunjamini**  
FABRIKA E LLAQEVE  
MITROVICË  
044/256-051  
044/367-061  
028/532-617  
STYROKOL · BUNJAKOL · CUROFASADË

**Kolegji  
BIZNESI**  
[www.kolegji.biznesi.com](http://www.kolegji.biznesi.com)  
info@kolegji.biznesi.com  
038 500 878 | 045 500 878  
044 500 878 | 049 500 878

**SIGMA**  
VIENNA INSURANCE GROUP  
SIGMA INTERALBANIAN VIENNA INSURANCE GROUP SH.A  
DEGA KOSOVË  
Rruga "Pashko Vasa", p.n. Prishtinë, Kosovë,  
Tel: +381 (0)38 246 301 Fax: +381 (0)38 246 302,  
E-mail: [info@sigma-ks.net](mailto:info@sigma-ks.net) | [www.sigma-ks.net](http://www.sigma-ks.net)

**INFINITY**  
Digital Agency  
Endrit Shaqiri  
+38344685122  
Internet Website,  
Marketing...

# ShBA-ja do të largohet përsëri nga UNESCO-ja, vetëm dy vjet pasi iu ribashkua

UASHINGTON, 22 KORRIK - Shtetet e Bashkuara të Amerikës (ShBA) kanë bërë me dije të martën se do ta braktisin përsëri agjencinë e Organizatës së Kombeve të Bashkuara për Edukim, Shkencë dhe Kulturë (UNESCO) për shkak se besojnë se përfshirja e tyre në të nuk është në interesin e tyre kombëtar dhe se UNESCO-ja mbështet gjuhë kundër Izraelit. Ky vendim vjen vetëm dy vjet pasi Shtetet e Bashkuara të Amerikës i ishin ribashkuar UNESCO-s, pas largimit më 2018, gjatë administratës së parë të presidentit Donald Trump, raporton "AP". Zëdhënësja e Departamentit Amerikan të Shtetit, Tammy Bruce, ka thënë se tërheqja lidhet me agjendën e perceptuar të UNESCO-s për "mbështetjen e kauzave përçarëse sociale dhe kulturore". Ajo ka shtuar, në një komunikatë, se vendimi i UNESCO-s "për ta pranuar 'Shtetin e Palestinës' si shtet anëtar është tejet problematik, në kundërshtim me politikën e ShBA-së, dhe se i kontribuon ashpërsimit të retorikës kundër Izraelit brenda organizatës". Vendimi do të hyjë në fuqi në

fund të dhjetorit të vitit 2026. Kjo do të jetë hera e tretë që ShBA-ja do të largohet nga UNESCO-ja, e cila ka selinë në Paris, dhe hera e dytë gjatë një administrate Trump. Ajo i është ribashkuar agjencisë për herë të fundit më 2023, nën administratën e Joe Bidenit. Drejtorja e përgjithshme e UNESCO-s, Audrey Azoulay, ka thënë se me keqardhje "të thellë" ka pranuar vendimin e ShBA-së, por ka thënë se ai ishte i pritshëm dhe se agjencia "është përgatitur për të". Ajo i ka mohuar akuzat për anim kundër Izraelit. "Këto akuza... janë në kundërshti me realitetin e përpjekjeve të UNESCO-s, veçanërisht në fushën e edukimit për Holokaustin dhe luftën kundër antisemitizmit", është shprehur ajo. Administrata Trump ka njoftuar më 2017 se ShBA-ja do të tërhiqej nga UNESCO-ja, duke e akuzuar organizatën për anim kundër Izraelit. Vendimi hyri në fuqi një vit më vonë. ShBA-ja dhe Izraeli ndërpreu financimin e UNESCO-s, pasi organizata ka votuar për përfshirjen e Palestinës shtet anëtar më 2011.



Tërheqja e ShBA-së pritet të ketë ndikim mbi UNESCO-n për shkak se Uashingtoni mundëson një pjesë të buxhetit të organizatës. Por, UNESCO-ja pritet t'i dalë, teksa ka diversifikuar burimet e financimit gjatë viteve të fundit, ndërsa kontributi i ShBA-së është tkurrur, duke përbërë vetëm 8 për qind të buxhetit të përgjithshëm të organizatës. Azoulay është zotuar se UNESCO-ja do të vazhdojë ta kryejë misionin e saj pavarësisht

prej "resurseve të reduktuara", teksa ka bërë me dije se organizata nuk po planifikon ta shkurtojë stafin e saj tani për tani. "Qëllimi i UNESCO-s është t'i pranojë të gjitha kombet e botës dhe Shtetet e Bashkuara të Amerikës janë dhe do të jenë gjithmonë të mirëseardhura. Ne do të vazhdojmë do të punojmë ngushtë me të gjithë partnerët tanë amerikanë në sektorin privat, dhe organizata të shkencës dhe jofitimprurëse, dhe do të zhvillojmë dialog

politik me administratën dhe me Kongresin Amerikan", ka thënë Azoulay. Shtetet e Bashkuara ishin tërhequr nga UNESCO-ja edhe gjatë administratës së Ronald Reaganit, më 1984, duke e konsideruar organizatën të keqmenaxhuar, të korruptuar dhe të keqpërdorur për avancimin e interesave të Bashkimit Sovjetik. ShBA-ja ishte kthyer në UNESCO më 2003 gjatë presidencës së George W. Bushit.

## Britania ia jep dritën jeshile centralit bërthamor për 45 miliardë euro



LONDËR, 22 KORRIK - Qeveria britanike ka dhënë miratimin përfundimtar për një central bërthamor prej 38 miliardë paundësh (rreth 45 miliardë euro) në Anglinë lindore. Projekti "Sizewell C në Suffolk" do të financohet bashkërisht nga fondi kanadez i pensioneve La Caisse, firma britanike e energjisë "Centrica" dhe "Amber Infrastructure", shkruajnë mediet britanike. Autoritetet kanë thënë se "Sizewell C" do të ofrojë energji të pastër për ekuivalentin e gjashtë milionë shtëpive si dhe do të mbështesë 10 000 vende pune dhe do të krijojë 1 500 vende pune sapo të jetë funksional, gjë që pritet të jetë në vitet 2030. Qeveria do të jetë aksionarja më e madhe në projekt me një pjesëmarrje prej 44.9-

përqindësh. La Caisse do të mbajë një pjesëmarrje prej 20-përqindësh, Centrica 15 për qind dhe Amber Infrastructure do të marrë një pjesëmarrje fillestare prej 7.6-përqindësh. Sekretari i Energjisë, Ed Miliband, ka thënë se "është koha për të bërë gjëra të mëdha dhe për të ndërtuar projekte të mëdha përsëri në këtë vend". Dhe sot ne njoftojmë një investim që do të sigurojë energji të pastër dhe vendase për miliona shtëpi për brezat që do të vijnë. Kjo qeveri po bën investimin e nevojshëm për të ofruar një epokë të re të artë të energjisë bërthamore, në mënyrë që të mund t'u japim fund vonësive dhe të çlirohemi nga shkatërrimet e tregjeve globale të karburanteve fosile për t'i ulur faturat përgjithmonë", ka thënë Miliband.

## Franca njofton një tjetër paketë sanksionesh kundër Rusisë

PARIS, 22 KORRIK - Ministria e Punëve të Jashtme e Francës ka nisur përgatitjet për një tjetër paketë sanksionesh të BE-së kundër Rusisë. Kryediplomati francez Jean-

Noel Barot ka thënë se kjo paketë e re sanksionesh ka për ta detyrojë presidentin rus Vladimir Putin që ta pranojë armëpushimin në Ukrainë. Gjithashtu, ai ka

squaruar se bëhet fjalë për sanksione që janë marrë në nivelin e BE-së dhe jo konkretisht për Francën. "Unë tashmë u kam kërkuar ekipeve të mia të përgatitin

një paketë të re edhe më të ashpër kundër Rusisë, me qëllim që ta detyrojnë Putinin ta pranojë armëpushimin në Ukrainë", ka thënë ai.



NË HAGË MBAHET KONFERENCA STATUSORE PËR RASTIN NDAJ LIDERËVE TË UÇK-së

# AVOKATI I THAÇIT GODET GJYQTARËT E SPECIALES: S'PO NA JEPNË AFAT TA PËRGATITIM MBROJTJEN

Avokati i Hashim Thaçit, Lluka Misetiq, është ankuar se trupi gjykues ka refuzuar kërkesën prej 10 javësh që mbrojtja ta përgatisë çështjen e saj, duke thënë se më 25 gusht mbrojtja duhet ta nisë rastin. “Gjykata ka ulur kohën për përgatitjen e mbrojtjes nga 10 javë në 2 javë”, ka thënë ai, duke shtuar se ky afat është barrë e madhe për ekipin e tij. Ai ka thënë se trupi gjykues ka vendosur për disa afate të kërkuara nga ZPS-ja pa dëgjuar parashtrimet e mbrojtjes. Ai i ka pyetur gjyqtarët se kur e kanë trajtuar ZPS-në sikurse mbrojtjen e liderëve të UÇK-së

EPOKA  
ERE

Lirim GECI

**HAGË, 22 KORRIK** - Në Gjykatën Speciale është mbajtur konferenca statusore për rastin ndaj liderëve të UÇK-së, Hashim Thaçi, Kadri Veseli, Rexhep Selimi dhe Jakup Krasniqi. Avokati i Thaçit, Luka Misetiq, ka goditur ashpër gjyqtarët në procesin gjyqësor ndaj katërsheve të UÇK-së. Misetiqi ka thënë se gjyqtarët i kanë ndërruar afatet për paraqitjen e rastit të mbrojtjes. Ai ka thënë se nga dhjetë javë për paraqitjen e rastit të mbrojtjes, gjyqtarët e kanë shkurtuar afatin në dy javë. “Sa i takon kohës që ka kaluar, periudhës së 6 javëve të fundit, dua ta ritheksoj mënyrën si e kemi kuptuar ne historikun procedural. Ekipet e mbrojtjes kanë marrë përgjigje se do të kenë 10 javë kohë pasi të jepet vendimi, duke mos llogaritur pushimin e verës. Trupi gjykues ka

ndryshuar qëndrimin e tij, na ka dhënë tjetër parashtrim, që trupi gjykues që përcaktoi afatet për aspektet e provave të mbrojtjes, duke përfshirë edhe ofrimin e dëshmitarëve dhe listës së provave materiale. Ka vendosur edhe konferencën për përgatitjen e mbrojtjes”, ka thënë Misetiq Sipas avokatit të Thaçit, më 23 qershor Zyra e Prokurorit të Specializuar është përgjigjur duke kundërshtuar ndryshimin. “Një prej arsyeve që kemi kundërshtuar është se mbrojtja duhet ta ketë mundësinë e barabartë të dëgjohet. Më 2 korrik trupi gjykues rrëzoi kërkesën tonë për ndryshim të afateve, në përjashtim të datës për konferencë për përgatitjen e mbrojtjes. Trupi gjykues vendosi për disa afate të kërkuara nga ZPS-ja pa dëgjuar parashtrimet e mbrojtjes. Sipas këtij urdhri, mbrojtja e Thaçit, duke qenë se është i akuzuari i parë,

është urdhëruar t'i paraqesë provat e veta nga 25 gushti 2025, trupi gjykues ka reduktuar kohën në dispozicion të mbrojtjes, me 10 javë siç ishte planifikuar, dhe në vend të 15 tetorit, ka vendosur që çështja të fillojë më 25 gusht. Dhe ndërkohë e gjithë kjo është bërë pa asnjë lloj njoftimi nga shkurti deri në qershor, duke mos marrë fare parasysh vështirësitë që ka mbrojtja për përmbushjen e afateve”, ka thënë Misetiqi, duke shtuar se avokatëve të liderëve të UÇK-së u takojnë dhjetë javë për ta përgatitur mbrojtjen.

“Parashtrimi ynë është që nuk na keni dëgjuar, por mbrojtja i ka kërkuar konkretisht se çka mendon. Shprehimisht trupi gjykues ka thënë se kjo është e pranueshme. Të akuzuarit kanë të drejtë të kundërpërgjigjen në pranimin e gjerë për 10 javë, çka i takon ky afat kohor që do të jetë nga 10 tetori, duke përfshirë edhe afatet për kërkesa sipas Rregullës 107”, ka thënë Misetiqi.

Më tutje, avokati e pyeti gjykatën se kur e kanë trajtuar ZPS-në njëjtë si avokatët, duke mos u dhënë kohë të përgatiten. “Trupi gjykues e ka ulur kohën për përgatitjen e mbrojtjes nga 10 javë në 2

javë, dhe kjo ka krijuar barrë të shtuar e vështirësi për ekipin tim që po punon 12 orë në ditë. Ne nuk jemi në dijeni nëse trupi gjykues e ka trajtuar ZPS-në në një mënyrë të tillë që ka vendosur afate pa i dhënë ZPS-së mundësinë të dëgjohet. Këto janë afate që kanë krijuar shumë vështirësi për përgatitjen e mbrojtjes. Ne kërkojmë të na jepet mundësia të shpjegohet pse nuk na është dhënë e drejta jonë për këto afate”, ka thënë avokati Misetiqi.

Ndërsa trupi gjykues e ka pyetur avokatin e Jakup Krasniqit, Aidan Ellis, nëse ekipi i tij është gati ta nisë paraqitjen e dëshmitarëve më 25 gusht në mënyrë që ekipi i Thaçit të përgatitet, por ai tha që nuk është gati.

Trupi gjykues ka pyetur se sa dëshmitarë planifikon mbrojtja e Thaçit dhe Krasniqit të thërrasë. Mbrojtja e Thaçit ka thënë se 12 dëshmitarë planifikon t'i ftojë, 11 prej të cilëve synojnë të japin dëshminë në gjykatë dhe një përmes dëshmisë me shkrim. Ndërkaq, mbrojtja e Krasniqit ka thënë se synon të thërrasë pesë dëshmitarë. ZPS-ja ka deklaruar më 16 prill se ka përmblytur paraqitjen e provave ndaj ish-krerëve të UÇK-së.

Procesi gjyqësor ndaj liderëve të UÇK-së ka nisur më prill të vitit 2023. Që mbi dy vjet, Zyra e Prokurorit të Specializuar ka thirrur në gjykatore 125 dëshmitarë si dhe ka paraqitur rreth 3 000 prova materiale.

Kujtojmë se më 16 korrik Gjykata Speciale në Hagë ka refuzuar plotësisht mocionin e mbrojtjes që kërkonte heqjen e disa fakteve materiale nga aktakuzat ndaj liderëve të UÇK-së, Hashim Thaçi, Kadri Veseli, Rexhep Selimi dhe Jakup Krasniqi. Mocioni kishte për qëllim ta sfidonte përfshirjen e ngjarjeve që kanë ndodhur para majit të vitit 1998 dhe pas 20 qershorit 1999.

Thaçi, Veseli, Selimi dhe Krasniqi ndodhen në qendrën e paraburgimit në Hagë që nga nëntori i vitit 2020. Ata janë deklaruar të pafajshëm në raport me akuzat e Speciales. Katërsheja e UÇK-së ka bërë disa herë kërkesa për lirim me kusht, por nuk janë marrë parasysh nga Gjykata Speciale. Që nga fillimi i procesit gjyqësor janë larguar disa nga avokatët kryesorë për shkak të çështjeve financiare. Për këtë çështje janë kritikuar ashpër institucionet e Kosovës të cilat që nga fillimi i këtij procesi gjyqësor janë duke u drejtuar nga Lëvizja Vetëvendosje.



## 15 vjet nga vulosja e pavarësisë së Kosovës

Prishtinë, 22 korrik - 15 vjet më parë Gjykata Ndërkombëtare e Drejtësisë (GjND) në Hage, më 22 korrik 2010, kishte konfirmuar se shpallja e pavarësisë së Kosovës më 17 shkurt 2008 nuk e ka shkelur të drejtën ndërkombëtare, duke hedhur poshtë pretendimin e Serbisë. “Miratimi i Deklaratës së Pavarësisë më 17 shkurt 2008 nuk ka shkelur as të drejtën ndërkombëtare të përgjithshme, as Rezolutën 1244 (1999) të Këshillit të Sigurimit të Kombeve

të Bashkuara, as kuadrin kushtetues. Për rrjedhojë, miratimi i asaj deklarate nuk ka shkelur asnjë normë të zbatueshme të së drejtës ndërkombëtare”, kishte thënë GjND-ja, duke e shënuar këtë moment në histori. Kryetari i atëhershëm i GjND-së, Hisashi Ovada, ka kujtuar se e drejta ndërkombëtare nuk përmban ndalesë për adoptimin e deklaratave të pavarësisë dhe, rrjedhimisht, pavarësia e Kosovës

nuk e shkel të drejtën e përgjithshme ndërkombëtare. Dhjetë gjykatës kishin votuar në favor të këtij vendimi, ndërsa katër prej tyre kundër.

Ky vendim historik i GjND-së është përshëndetur gjerësisht si një fitore e të drejtës dhe vullnetit demokratik të qytetarëve të Kosovës. Ai ka hequr dilemat ligjore mbi legjitimitetin e pavarësisë dhe ka ndihmuar Kosovën në rrugën e saj drejt afirmimit ndërkombëtar. Liderët e



partive politike në Kosovë e kanë rikujtuar këtë moment historik, përfshirë Albin Kurti, Lumir Abdixhiku, Ramush Haradinaj.

Kryeministri në detyrë, Albin Kurti, ka thënë se vendimi i GjND-së kishte vulosur pavarësinë e Kosovës.

# SHËRBIMET KROATE: PËRSHKALLËZIMI I TENSIONEVE NË KOSOVË, RREZIK I VAZH DUESHËM

ZAGREB, 22 KORRIK - Agjencia e Sigurisë dhe Inteligjencës e Kroacisë (SOA) ka vlerësuar se marrëdhëniet ndërmjet Kosovës dhe Serbisë mbeten të paqëndrueshme dhe se, në këto rrethana, përshkallëzimi i tensioneve në Kosovë paraqet një rrezik të vazhdueshëm. Në raportin e saj vjetor, SOA ka hedhur dritë jo vetëm mbi situatën e sigurisë në Kroaci, por edhe mbi zhvillimet në Ballkanin Perëndimor - një rajon që, sipas saj, vazhdon të përballlet me sfida të thella politike dhe të sigurisë, të lidhura ngushtë me çështjet e pazgjidhura ndërshtetërore. Edhe pse BE-ja dhe ShBA-ja mbeten të përfshira në përpjekjet për stabilizim, raporti nënvizon se zgjidhja e këtyre çështjeve vazhdon të jetë e vështirë. Kjo klimë pasigurie, sipas SOA-s, ndikon drejtpërdrejt edhe në procesin e integritetit evropian të rajonit, i cili po ecën me ritme të ngadalta. Në vlerësimin e saj për Kosovën, SOA ka theksuar ekzistencën e grupeve që synojnë destabilizimin e situatës në veri të vendit, ku shumica e popullsisë është serbe. Si shembull për këtë, raporti ka përmendur sulmin e armatosur të formacioneve serbe ndaj Policisë së Kosovës në fshatin Banjskë më 24 shtator të vitit 2023, në të cilin mbeti i vrarë një polic. Prishtina e ka akuzuar Beogradin për këtë sulm, ndërsa zyrtarët serbë kanë mohuar çdo përgjegjësi. Raporti vëren se ende nuk është e qartë se si është organizuar ky formacion paraushtarak dhe si është armatosur me armë të rënda me origjinë ushtarake. Për Millan Radoičiqin, i cili ka marrë përgjegjësinë për organizimin e sulmit dhe ka qenë pjesëmarrës në të, raportohet se është larguar në Serbi, ku është marrë në pyetje, por ende pritet ngritja e procedurave penale kundër tij. Raporti i SOA-s ka përmendur edhe përpjekjet e autoriteteve të Kosovës për t'i shuar institucionet paralele serbe në veri, me qëllim forcimin e sovranitetit të shtetit dhe kufizimin e ndikimit të



Beogradit në këtë zonë. “Në rrethana të tilla, përshkallëzimi i tensioneve në Kosovë mbetet një rrezik i vazhdueshëm. Ndaj, rolin e garantuesit të sigurisë vazhdon ta luajë prania ushtarake e forcave ndërkombëtare”, ka përfunduar SOA. Për fqinjën veriore të Kosovës, Serbinë, SOA ka theksuar vazhdimësinë e politikës së balancimit midis Perëndimit, Rusisë dhe Kinës. Kjo strategji përfshin edhe promovimin e konceptit të “botës serbe”, i cili synon bashkimin e serbëve në vendet fqinje - sidomos në Bosnjë-Hercegovinë, Mal të Zi dhe Kosovë - nën ombrellën e unifikuar politike të Beogradit zyrtar. Në nivelin e brendshëm, SOA ka vërejtur se Serbia ka përjetuar disa valë protestash antiqeveritare, të organizuara kryesisht nga studentët, të cilët kërkojnë demokratizim të shoqërisë, depolitizim të institucioneve shtetërore, forcim të lirisë së medias dhe luftë kundër korrupsionit. Raporti ka theksuar se në një

situatë të tillë të ndërlikuar, me polarizim shoqëror në rritje - mediet pranë strukturave qeverisëse përforcojnë një narrativë që identifikon armiq të jashtëm dhe të brendshëm. Sipas raportit, kjo krijon një atmosferë të kërcënimit kombëtar dhe përdoret për t'i diskredituar protestat studentore. Në këtë kontekst, Republika e Kroacisë përmendet si një “faktor i përhershëm antiserb”, ka vlerësuar SOA. Agjencia kroate ka vërejtur se në Bosnjë-Hercegovinë vazhdon paqëndrueshmëria politike, e shkaktuar nga mosmarrëveshjet midis entiteteve dhe komuniteteve për rregullimin kushtetues dhe politikën e jashtme. Konflikti kryesor qëndron midis udhëheqjes së Republikës Sërpska dhe Përfaqësuesit të Lartë mbi juridiksionin. SOA ka vlerësuar se udhëheqja e Republikës Sërpska mbështet hapur shpërbërjen e Bosnjë-Hercegovinës dhe kërkon mbështetje politike nga Rusia - gjë që do të vazhdojë të krijojë sfida

serioze politike dhe të sigurisë. Në Mal të Zi, sipas raportit, vazhdon ndarja socio-politike mes opsionit proevropian dhe atij serb, i cili është njëkohësisht prorus dhe antiperëndimor. Partitë radikale serbe janë pjesë e koalicionit aktual qeverisës, dhe megjithëse qeveria malazeze synon të demonstrojë angazhim evropian, ndikimi i politikave nacionaliste dhe antiperëndimore të opsionit serb mund ta pengojë integritetin evropian dhe t'i ndikojë negativisht marrëdhëniet me BE-në, vlerëson raporti i SOA-s. Raporti i SOA-s ka përmendur edhe Kishën Ortodokse Serbe që, përveç rolit fetar, thotë se ka edhe ndikim të fuqishëm politik - kombëtar dhe rajonal. Udhëheqësit e Kishës promovojnë konceptin e “botës serbe”, duke përfshirë veçanërisht Bosnjë-Hercegovinën, Malin e Zi dhe Kosovën si pjesë të kësaj hapësire, vë në dukje raportin. I njëjti ka paralajmëruar, gjithashtu, se organizatat kriminale të Ballkanit Perëndimor, sidomos ato serbo-

malazeze, janë shumë aktive në trafikimin e kokainës nga Amerika e Jugut drejt Evropës. Në një pjesë të raportit, SOA ka theksuar edhe ndikimin e vazhdueshëm dhe destabilizues të Rusisë në Ballkanin Perëndimor. Moska, sipas raportit, përdor një gamë mjetes - sidomos lidhjet tradicionale me Serbinë - për ta ruajtur dhe zgjeruar ndikimin e saj në rajon. Agjencia vëren, gjithashtu, praninë aktive të shërbimeve ruse të inteligjencës në Serbi, të cilat, sipas SOA-s, përfshijnë edhe strehimin e agjentëve të larguar nga vendet perëndimore. Raporti ka vlerësuar se nga territori serb operojnë edhe mjete hibride ruse dhe përmend në mënyrë të veçantë “RT”-në dhe “Sputnik”-un. Këto medie “shërbejnë për të përhapur narrativë proruse dhe antiperëndimorë në Ballkanin Perëndimor”, ka theksuar raporti i NOA-s. Për vetë Kroacinë, SOA ka vlerësuar se është një “demokraci e sigurt dhe e qëndrueshme në një mjedis sfidues të sigurisë”.

## Rohde viziton gjermanët në Bondsteel, “teston” pajisjet që përdoren në patrullat kufitare Kosovë - Serbi



PRISHINË, 22 KORRIK - Para pak ditësh ambasadori gjerman në Kosovë, Jorn Rohde, bashkë me zëvendësin e tij Christian Bottcher, kanë vizituar trupat gjermane të KFOR-it të stacionuara në Kampin Bondsteel pranë Ferizajt. Ai është informuar mbi misionet aktuale, aftësitë operacionale dhe pajisjet teknike të përdorura gjatë patrullave dhe vëzhgimeve kufitare përgjatë kufirit Kosovë - Serbi. “U ndjeva sikur u ktheva në shtëpi”, ka thënë ambasadori Rohde, duke kujtuar kështu

kohën e tij në Gjermani në vitet '80. Siç është thënë në njoftimin e Ambasadës së Gjermanisë, ambasadori Rohde, duke parë automjetet e blinduara moderne e deri te sistemet e avancuara të mbikëqyrjes, u impresionua nga preciziteti, profesionalizmi dhe përkushtimi që trupat demonstuan në përmbytjen e mandatit të KFOR-it. “Një moment i veçantë për të ishte rikthimi në kontrollin e një ngarkuesi ‘Ahlman’-n me krah rrotullues, tashmë i modernizuar, por ende i njohur

nga koha e shërbimit të tij dekada më parë”, ka njoftuar Ambasada e Gjermanisë në Kosovë. Rohde ka pasur një falënderim të sinqertë për të gjithë ushtarët gjermanë që shërbejnë në Kosovë. “Puna juaj është thelbësore, ekspertiza juaj e jashtëzakonshme dhe përkushtimi juaj vlerësohet thellësisht. E kaluara takon të tashmen - aty ku shërbimi i përbashkët vazhdon ta formësojë paqen dhe sigurinë në Kosovë”, ka njoftuar Ambasada e Gjermanisë.

## Kusari-Lila për bllokadën në Kuvend: T'i thërrasim mendjes, ta kapërcejmë ngërçin

PRISHTINË, 22 KORRIK - Kryetarja e Alternativës, Mimoza Kusari-Lila, u ka bërë thirrje të gjitha partive t'i thërrasin mendjes, ta ulin tonin e polarizimit dhe ndasive dhe ta kapërcejnë ngërçin institucional në Kuvendin e Kosovës. Ajo në një konferencë për medie ka thënë se obligimi kushtetues është shndërruar në veprim politik nga disa subjekte. "Jemi të gjithë dëshmitarë të 50 përpjekjeve të dështuara për Kuvendin e Kosovës, në

të cilin institucione, subjekte të caktuara, fatkeqësisht, kanë vendosur që një obligim kushtetues ta marrin si një veprim politik. Edhe sot, nga këtu, thirrje të gjitha partive pa dallim që t'i thërrasin mendjes, ta ulin tonin e polarizimit dhe ndasive, të cilat po mundohen të ushqehen në Kuvendin e Kosovës, të marrin pjesë në votim sipas vullnetit të tyre dhe ta kapërcejmë këtë ngërç, i cili po i kushton vendit dhe qytetarëve të saj.

Më e rrezikshme është humbja e besimit nga brenda dhe e kemi vështirë ta rikthejmë dinamikën e angazhimit qoftë për të mirën e vendit, qoftë për të mirën e tyre", ka thënë Kusari-Lila. Në këtë konferencë Kusari-Lila ka bërë me dije se Alternativa do të garojë e vetme në zgjedhjet lokale në gjashtë komuna: Prishtinë, Gjakovë, Pejë, Prizren, Mitrovicë të Jugut dhe Mitrovicë të Veriut.



# OSMANI I DREJTOHET KUSHTETUESES, KËRKON SQARIME PËR PASOJAT JURIDIKE TË MOSKONSTITUIMIT TË KUVENDIT

PRISHTINË, 22 KORRIK - Presidentja e Kosovës, Vjosa Osmani, ka njoftuar të martën se i është drejtuar Gjykatës Kushtetuese për të kërkuar sqarim nëse Kuvendi i Kosovës nuk konstituohet deri më 26 korrik, afati i përcaktuar nga gjykata më herët përmes një aktgjykimi. "Kërkesa jonë sot, në esencë, është kërkesë për sqarim të pasojave juridike të moskonstituimit të Kuvendit brenda afatit kushtetues prej 30 ditësh. Çdo afat i detyrueshëm kushtetues dhe çdo moszbatim duhet të ketë pasojë juridike, por ato nuk janë sqaruar në aktgjykimin paraprak. Kërkesa jonë sot në esencë është kërkesë për sqarimin e pasojave juridike të moskonstituimit të Kuvendit brenda 30 ditësh", ka thënë

Osmani në një konferencë për medie. Sipas Osmanit, qëllimi është të sqarohet situata për moskonstituimin e Kuvendit brenda afatit 30-ditor dhe të sqarohen se si ushtrohen kompetencat e secilit institucion kushtetues në mungesë të konstituimit të një prej shtyllave kryesore të parimit të ndarjes së pushteteve, që është Kuvendi. Në këtë kontekst, Osmani ka kërkuar nga Kushtetuesja "masë të përkohshme" për Kuvendin. Gjykata Kushtetuese e Kosovës i ka obliguar deputetët ta konstituojnë organin ligjvënës deri më 26 korrik. Më 21 korrik deputetët për herë të 50 kanë dështuar ta konstituojnë Kuvendin e Kosovës, pasi partitë që mandatin e kaluar ishin në



opozitë janë duke kundërshtuar ndryshimin e mënyrës së votimit për kryeparlamentar nga i hapur

në të mbyllur.

Sot (e mërkurë) do të tentohet përsëri të konstituohet

legjislatura e nëntë, ndonëse partitë nuk kanë lëvizur nga pozicionet fillestare.

# MINISTRIA E SHËNDETËSISË REKOMANDON MASA MBROJTËSE NGA VAPA

PRISHTINË, 22 KORRIK - Ministria e Shëndetësisë (MSH) u ka rekomanduar institucioneve publike dhe private në Kosovë të zbatojnë masa mbrojtëse për mbrojtjen e punëtorëve nga temperaturat e larta në periudhën 22-25 korrik. Ministria i ka bazuar këto rekomandime në udhëzimet e Institutit Kombëtar të Shëndetësisë Publike (IKShPK). Në njoftimin e MSh-së është përmendur që temperaturat e larta ndikojnë negativisht në shëndetin e njeriut, veçanërisht te grupet më të ndjeshme të



shoqërisë, si: fëmijët, të moshuarit, gratë shtatzëna,

personat me sëmundje kronike, si dhe te punëtorët që punojnë

në ambiente të hapura apo në kushte pune me temperatura të larta. Sipas rekomandimit të ministrisë: duhet të shmangët puna në ambient të jashtëm në periudhën kohore 11:00-16:00, gratë shtatzëna duhet të lirohen nga puna nga ora 11:00 deri në 16:00, personat me sëmundje kronike duhet të punojnë me orar të shkurtuar, maksimumi 4 orë në ditë, duhet të përshtaten oraret e punës për të punësuarit, në mëngjes herët ose pasdite vonë, përfshirë edhe mundësinë e punës nga shtëpia, duhet të

sigurohet ajrosja e mjaftueshme në vendet e punës të mbyllura dhe duhet të vendosen pika freskimi në vendpunishtet e hapura për freskim të punëtorëve dhe të sigurohet qasje në ujë të ftohtë për ta. Temperaturat këtë javë në Kosovë pritet të shkojnë deri në 38 gradë celsius. Si pasojë e motit të nxehtë që ka përfshirë Ballkanin, në Shqipëri, Maqedoni të Veriut dhe Kroaci është raportuar për përhapje të zjarreve, pasi temperaturat në disa raste kanë shkuar mbi 40 gradë celsius.

## Bildt: Bllokada politike ka dëmtuar besueshmërinë e shtetit të Kosovës, kjo është keq për të gjithë



PRISHTINË, 22 KORRIK - Ish-kryeministri suedez Carl Bildt ka reaguar për bllokadën politike në Kosovë. Bildt ka thënë se pamundësia për të ecur

përpara e ka dëmtuar kredibilitetin e shtetit të Kosovës dhe se kjo është gjë e keqe për të gjithë. "A do të ketë ndonjëherë Kosova një qeveri të re?

Pamundësia për të ecur përpara dëmtoi besueshmërinë e vendit. Dhe kjo është keq për të gjithë", ka shkruar Bildt në platformën "X".

Zgjedhjet parlamentare në Kosovë janë mbajtur më 9 shkurt, ndërsa Kuvendi i Kosovës nuk është konstituuar as në tentimin e 50.



# NË KOSOVË KËRKOHEN PËR MASAKRËN NË MEJË, NË SERBI JANË FIGURA PUBLIKE

**PRISHTINË, 22 KORRIK** - Banka e të akuzuarve në sallën e gjyqit në Prishtinë ishte e zbrazët kur kishte nisur gjykimi për krimet e luftës, të kryera mbi 25 vjet më parë nga forcat ushtarake dhe policore serbe, në Mejë të Gjakovës.

Nga mesi i qershorit të akuzuarit janë duke u gjykuar në mungesë, pasi nuk janë në dispozicion të drejtësisë së Kosovës. Kundër tyre është lëshuar edhe një fletarrestim ndërkombëtar. Beogradi zyrtar tash për tash është duke heshtur. Ushtria e Serbisë ka thënë për “Radion Evropa e Lirë” se “nuk ka informacion” në lidhje me pjesëtarët e saj që figurojnë në aktakuzën e Kosovës, ndërsa policia nuk përgjigjet në pyetje.

Më shumë se 50 të pandehur, përfshirë ish-udhëheqës të forcave ushtarake dhe policore serbe, akuzohen për vrasjen e 370 shqiptarëve të Kosovës në Mejë dhe në fshatra të tjerë përreth Gjakovës gjatë luftës së vitit 1999. Mbi një çerek shekulli pas masakrës, shumica e të akuzuarve janë në pension, dhe kundër tyre në Serbi, zyrtarisht nuk është duke u zhvilluar

ndonjë hetim.

Disa janë aktivë në jetën publike - shkruajnë dhe promovojnë libra, angazhohen në politikë dhe shfaqen në medie. Në kërkim të të akuzuarve, “Radio Evropa e Lirë” ka analizuar bazat e disponueshme të të dhënave dhe arkivat.

**Çfarë ndodhi në fshatrat përreth Gjakovës?**

Sipas aktakuzës së Prokurorisë së Kosovës, por edhe vendimeve të mëhershme të Tribunalit të Hagës, forcat ushtarake dhe policore serbe kanë zhvilluar nga 27 deri më 29 prill të vitit 1999 një operacion të përbashkët, të quajtur “Reka”, sipas emrit të luginës me mbi 20 fshatra në rajonin e Gjakovës. Në këtë operacion, qëllim i të cilit ishte spastrimi etnik i zonës nga banorët e saj, u vranë 370 civilë dhe disa mijëra janë dëbuar në Shqipëri. Prona e tyre është plaçkitur dhe shtëpitë e tyre janë djegur. Shumica e të vrarëve jetonin në fshatrat malore të Mejës dhe Korenicës. Trupat e shumicës janë gjetur në vitin 2001 në tetë varre

masive në periferi të Beogradit, ndërsa 18 viktima të masakrës janë ende të zhdukura. Operacioni “Reka” është konceptuar nga Korpusi i Prishtinës i Ushtrisë së atëhershme jugosllave dhe krerët e Ministrisë së Punëve të Brendshme (MUP).

**I dyshuari kryesor, “opozitar” në Nish**

“Nuk më shkon ndër mend të shkoj në gjykim në Prishtinë, por do të paraqitesha gjithmonë para një gjykate në Beograd”, ka thënë për “Radion Evropa e Lirë”, Momir Stojanoviq, ish-shef i Sigurisë së Korpusit të Prishtinës dhe i dyshuar kryesor në aktakuzën e Kosovës. Si gjeneral ushtarak në pension, ai jeton në Nish - në jug të Serbisë. Deri në vitin 2016 ishte zyrtar i Partisë Përparimtare Serbe në pushtet, ndërsa sot thotë se është një “opozitar autentik” dhe kritik i ashpër i presidentit serb Aleksandër Vuçiq. Në zgjedhjet lokale të vitit 2020 në Serbi, Stojanoviqi ka udhëhequr grupin qytetar “Sinqerisht për Nishin”, i cili nuk arriti ta kalonte

pragun zgjedhor. Stojanoviqi ka thënë për “Radion Evropa e Lirë” se për masakrën në Mejë dhe fshatrat e tjera ka mësuar disa vjet më vonë në Hagë, ku ka qenë dëshmitar i mbrojtjes në gjyqet ndaj udhëheqësve të ushtrisë dhe policisë serbe.

“Nuk kam dijeni për vuajtjet e atyre civilëve dhe me përgjegjësi pohoj se ushtria nuk ka të bëjë fare me atë krim. Nuk mund të them nëse anëtarët e Ministrisë së Punëve të Brendshme kanë bërë diçka. Kjo është një çështje për ta”, ka thënë Stojanoviqi.

Ai ka theksuar se Tribunali i Hagës “ka vërtetuar në mënyrë të pakundërshtueshme se ai nuk është përgjegjës”. “Në luftën në Kosovë unë nuk kam komanduar asnjë ushtar, nuk kam komanduar ndonjë operacion, as nuk kam planifikuar operacione. Puna ime ishte të mbledhja të dhëna mbi forcën, përbërjen dhe vendndodhjen e formacioneve terroriste të UÇK-së (Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës) dhe kalimet e tyre të paligjshme të kufirit”, ka thënë Stojanoviqi.

Ai ka pohuar se komanda e Korpusit të Prishtinës e ka planifikuar operacionin “Reka”

me qëllim “pastrimin e rajonit të Gjakovës nga terroristët”.

“Gjatë gjithë viteve 1998 dhe 1999 shumë ushtarë tanë kanë vdekur duke shkuar për ndërrim në postbloqet në kufi me Shqipërinë. Sa herë që është nisur automjeti ynë, terroristët e UÇK-së kanë ngritur prita dhe kanë vrarë ushtarë. Kështu ka ndodhur për ditë me radhë”, ka thënë Stojanoviqi.

**Çfarë konstatoi gjykata në Hagë?**

Edhe pse oficerët e lartë të ushtrisë serbe në dëshmitë e tyre në Hagë kanë thënë se qëllim i operacionit “Reka” ishte të ndalohej hyrja e luftëtarëve të UÇK-së nga Shqipëria, në mënyrë që ata të mos bashkoheshin me brigadën që vepronte në luginë, gjykata konstatoi se asnjëri nga të vrarët nuk ishte i armatosur dhe nuk mori pjesë aktive në luftë. “Për më tepër, nuk ka asnjë provë që, atëkohë, në atë zonë është zhvilluar ndonjë betejë midis forcave serbe dhe UÇK-së”, është thënë në vendimin e gjykimit për shefin e Drejtorisë

së Sigurisë Publike në Ministrinë e Punëve të Brendshme, Vllastimir Gjorgjeviq. Për krimet në operacionin “Reka” është dënuar pothuajse e gjithë udhëheqja ushtarake dhe policore serbe. Së bashku me Gjorgjeviqin është dënuar edhe komandanti i Korpusit të Prishtinës, Vlladimir Llazareviq, komandanti i Armatës së 3-të, Nebojsha Pavkoviq, shefi i Shtabit të Përgjithshëm, Dragolub Ojdaniq, dhe kreu i Ministrisë së Punëve të Brendshme të Serbisë për Kosovën, Sreten Llukiq. Deri më sot, asnjë person nuk është dënuar nga gjykatat në Serbi - as për krimet në operacionin “Reka”, as për fshehjen e trupave të viktimave në varre masive në Batajnicë, pranë Beogradit. Tribunali i Hagës nuk e ka hetuar përgjegjësinë e Stojanoviqit, sepse ai nuk u gjykua para asaj gjykate. Megjithatë, në vendimin për Gjorgjeviqin, ka thënë se pretendimi i Stojanoviqit se nuk ka pasur autoritet për të komanduar njësi, “nuk është i besueshëm”. “Është e paimagjinueshme që ai të mos ketë pasur informacione për pjesëmarrjen e njërive ushtarake në operacionin ‘Reka’, i cili është thënë se ka qenë i drejtuar kundër terroristëve, ose për dëbimin me forcë dhe vrasjen e fshatarëve gjatë ditëve kur është zhvilluar operacioni”, është thënë në vendimin e gjykatës. Duke folur për “Radion Evropa e Lirë”, Stojanoviqi ka përsëritur pretendimet e tij të mëparshme: se për varret masive në Batajnicë, ku janë gjetur trupat e viktimave në vitin 2001, ka mësuar nga mediat. Edhe pse më pas ka mbajtur pozitën e kreut të Agjencisë së Sigurisë Ushtarake, ai ka thënë se nuk ka bërë hetime, sepse “nuk ka pasur një kërkesë të tillë nga gjyqësori”. Si deputet nga Partia Përparimtare Serbe, Stojanoviqi ka kryesuar edhe Komisionin parlamentar për Kontrollin e Shërbimeve të Sigurisë. Derisa ishte në atë pozitë, Interpol-i kishte shpallur një urdhër arrestimi për të dhe për 17 persona të tjerë, për krime në rajonin e Gjakovës. Fletarrestimi ishte lëshuar nga prokurorët e Misionit të Bashkimit Evropian në Kosovë (EULEX). “Menjëherë kam kontaktuar Gjykatën tonë Speciale për krime lufte në Beograd. Hetimi ka zgjatur deri në vitin 2019, janë ndërruar tre prokurorë, dhe më pas është marrë vendimi për të hedhur poshtë kallëzimin”, ka thënë Stojanoviqi. Zyra e Prokurorit për Krime Lufte në Serbi nuk u është përgjigjur pyetjeve të “Radios Evropa e Lirë” në lidhje me arsyet e pezullimit të hetimeve, as çfarë informacionesh ka marrë në lidhje me masakrën dhe transferimin e mëvonshëm të trupave të të vrarëve, për të cilat ngjarje janë paraqitur prova edhe para Tribunalit të Hagës.

### Kush mori pjesë në krim?

Në aktakuzë është thënë se për këtë operacion, ushtria serbe angazhoi Brigadën e 549-të të Motorizuar - Batalioni 2, Brigadën e 125-të të Motorizuar, Brigadën e 63-të të Parashutistëve, Batalionin e 52-të të Policisë Ushtarake dhe Brigadën e 52-të të Artilerisë dhe Raketave. Ministria e Brendshme ka angazhuar mes tjerave, Njësitë Speciale të Policisë nga Gjakova dhe Prizreni, Njësinë e Operacioneve Speciale, të themeluar nga Shërbimi i Sigurisë Shtetërore Serbe, dhe anëtarë të mbrojtjes territoriale dhe formacione paraushtarake.

### Mirënjohje për Brigadën 125 “heroike”

Aktakuza e Kosovës përfshin edhe Dragan Zhivanoviqin, i cili, në kohën e krimit, komandonte Brigadën e 125-të të Motorizuar. Në dëshmitë e tij në Hagë, më herët, ai ka deklaruar se brigada e tij nuk ka marrë pjesë në plaçkitjen dhe djegien e fshatrave në Kosovë dhe se ushtarët e tij kanë qëlluar “vetëm ndërtesat ku kanë qenë terroristët”. Ai ka dalë në pension në vitin 2006 me gradën gjeneral-major. Sot, ai ftohet në programe televizive me frekuencë kombëtare në Serbi, në të cilat flet për ngjarjet në Kosovë dhe për “rrugën heroike” të brigadës së dikurshme. Së bashku me udhëheqjen ushtarake dhe shtetërore të Serbisë, ai u dhënë vazhdimisht dekorata anëtarëve të saj. E gjithë brigada, e cila është shpërbërë në vitin 2005 është dekoruar me “Urdhrin e Heroit të Popullit” për, siç është thënë në faqen zyrtare të Ushtrisë së Serbisë, “kontributin në mbrojtjen e atdheut, heroizëm dhe vetëflirijm”. Në vitin 2021, Ministria e Mbrojtjes e Serbisë ka prezantuar edhe filmin “Brigada Heroike e 125-të e Motorizuar”. Sipas Fondit për të Drejtën Humanitare, më shumë se 1 800 civilë janë vrarë në zonën e përgjegjësisë së kësaj brigade, në mesin e tyre mbi 500 gra dhe fëmijë. Më shumë se një dekadë më parë, ky fond ka ngritur dy padi penale kundër Zhivanoviqit për krime në Kosovë. Në vitin 2014, Zyra e Prokurorit në Serbi ka nisur hetime për përfshirjen e brigadës në krime. Ato janë pezulluar tre vjet më vonë dhe Zyra e Prokurorit nuk u është përgjigjur pyetjeve të “Radios Evropa e Lirë” në lidhje me arsyet.

### Kujtimet e familjeve të viktimave

Burri i Mira Krasniqit ishte një nga qindra civilët e marrë nga forcat serbe nga një fshat pranë Gjakovës, më 27 prill të vitit 1999. Ai ishte 39 vjeç atëkohë

dhe trupi i tij nuk u gjet kurrë. Ndërsa Mira kujton gjithçka: kolonat e grave dhe fëmijëve që dëboheshin, burrat që ndaheshin prej tyre, rrugët e mbushura me ushtarë serbë dhe urdhrat e tyre me armët ngritur: “Ikni, largohuni”. “I pari që e zbritën prej traktorit, ishte Alberti - djali i kunatit. Pastaj, i morën të gjithë burrat tjerë... Neve nuk na lejuan as të kthenim kokën e t'i shihnim. Vazhduam me kolonën drejt Shqipërisë”, ka kujtuar Mira për “Radion Evropa e Lirë”. Albert Krasniqi, atëkohë 17 vjeç dhe babai i tij janë gjetur më vonë në një nga varrezat masive në Batajnicë të Serbisë. Në atë prill, edhe Lush Krasniqi nga Ramoci i Gjakovës ka humbur dy vëllezër dhe një xhaxha. “I morën dhe shkuan nëpër shtëpi të tjera, ndërsa neve na urdhëruan që të largoheshim me traktor”, ka thënë Lushi. Trupat e familjarëve të tij janë gjetur gjashtë vjet më vonë në një nga varret masive në Batajnicë.

### Çfarë bëjnë veteranët e Brigadës 63 të Parashutistëve?

Udhëheqës i Brigadës së 63-të Ushtarake të Parashutistëve në kohën e krimit ishte Illija Todorov. Ai ka qëndruar në atë pozitë deri në vitin 2006, kur është emëruar komandant i parë i Brigadës Speciale të Ushtrisë së Serbisë. Ai ishte edhe zëvendëskomandant i Komandës së Përbashkët Operacionale dhe është pensionuat në vitin 2020. Ndryshe nga disa veteranë të kësaj brigade, të cilët morën pjesë në protestat antiqeveritare në Serbi, të organizuara nga studentët në muajt e fundit, Todorov është i afërt me udhëheqjen shtetërore dhe ushtarake. Në tetor të vitit të kaluar, përkrah kryeministrit të atëhershëm serb, Millosh Vuçeviq dhe ministrit të Mbrojtjes, Bratisllav Gashiq, ai ka folur në një ceremoni për shënimin e 80-vjetorit të themelimit të brigadës. “Sot është rasti për të shprehur mirënjohje dhe nderim për të gjithë ata që e vunë vetën në shërbim të formacionit të madh të Brigadës së 63-të të Parashutistëve”, ka thënë ai. Sipas gjetjeve të Gjykatës në Hagë dhe dëshmive të pjesëtarëve të ushtrisë, Brigada e 63-të e Parashutistëve ishte në krahun e majtë të forcave ushtarake-policore që kanë lëvizur nga veriperëndimi i Luginës së Rekës në juglindje dhe kanë dëbuar fshatarët. Gjatë luftës në Kosovë, kjo brigadë ishte kryesisht e angazhuar në postblloqet përgjatë kufirit me Shqipërinë.

### “Ruga e gjeneralit për në Kosmet”

Ish-komandanti i Brigadës së 52-të të Artilerisë dhe Raketave, Millosh Gjoshan, është në pension që nga viti 2001. Ai shkruan dhe promovon libra

për luftën në Kosovë dhe është shpesh i ftuar në televizionet serbe. Në mars të vitit të kaluar, në prezantimin e biografisë së Nebojsha Pavkoviqit, ai tha se është “nder dhe përgjegjësi e madhe për mua të flas për librin e heronjve dhe martirëve”. Pavkoviqi po vuan një dënim shumëvjeçar me burg në Finlandë, për krimet e kryera në Kosovë. Përveçse ka promovuar librat “Ruga e gjeneralit për në Kosmet” dhe “Nga agresioni i NATO-s në Tribunalin e Hagës”, Millosh Gjoshan ka marrë pjesë edhe në ceremoni të organizuara nga përfaqësuesit e Qeverisë serbe. Në kohën e krimit, brigada e Gjoshanit varej drejtpërdrejt nga Korpusi i Prishtinës. Në një deklaratë që i dha Komisionit për Bashkëpunim me Tribunalin e Hagës në vitin 2002, ai ka konfirmuar se një pjesë e njësisë së tij mori pjesë në operacionin “Reka”, por tha se ata pjesëtarë nuk ranë në kontakt me civilët. Si dëshmitar i mbrojtjes në gjyqin e Vllastimir Gjorgjeviqit në Hagë, ai ka thënë se “nuk kishte shumë informacione rreth aksionit” dhe se “nuk kishte dëgjuar asgjë për krimet” e kryera kundër popullsisë shqiptare.

### Zona e përgjegjësisë e Brigadës 549

Fshatrat në rajonin e Gjakovës i përkisnin zonës së përgjegjësisë së Brigadës së 549-të të Motorizuar, të udhëhequr nga Bozhidar Delliq. Pavarësisht akuzave dhe kallëzimeve penale të bëra kundër tij nga Fondi për të Drejtën Humanitare, në Serbi nuk kishte asnjë procedurë penale kundër Delliqit. Ai vdiq në gusht të vitit 2022, derisa ishte nënkryetar i Parlamentit serb. Marrë parasysh forcën dhe operacionet në të cilat kishte marrë pjesë, batalioni më i rëndësishëm brenda Brigadës së 549-të ishte Batalioni i 2-të i Motorizuar, i komanduar nga Vllatko Vukoviq. Si dëshmitar i mbrojtjes në gjyqin e ish-presidentit jugosllav, Slobodan Millosheviq, në Hagë, Vukoviqi kishte thënë se batalioni i tij kishte marrë një detyrë verbale nga Korpusi i Prishtinës, “për t'i ndihmuar civilët të kalonin kufirin dhe të shkonin në Shqipëri”. Si arsye përmendi “parandalimin e mundësisë së lëndimeve nga minat, që ishin vendosur nga forcat serbe”. Vukoviqi, i cili është në aktakuzën e Kosovës, ka dalë në pension në fillim të viteve 2000. Edhe brigadës së tij iu dha “Urdhri i Heroit të Popullit” në Serbi për “meritat e saj në kohë lufte”. Sipas dëshmive të disa oficerëve të lartë ushtarakë në Hagë, urdhri për të angazhuar ushtrinë në operacionin “Reka” ishte dhënë nga shefi i atëhershëm i Shtabit të Korpusit të Prishtinës, Verolub Zhivkoviq. Me urdhër gojor, ai u kishte kërkuar njërive ushtarake “ta siguronin zonën”. Zhivkoviqi

është i përfshirë në aktakuzën e Prokurorisë së Kosovës, ndërsa, sipas të dhënave të Fondit për të Drejtën Humanitare, ai është liruar nga detyra në vitin 2003. Sipas aktakuzës, në krim ka marrë pjesë edhe njësia e 52-të e Batalionit të Policisë Ushtarake, e cila drejtohej nga Sasha Antiq. Sipas dëshmisë së një pjesëtari të këtij batalioni, i cili dëshmoi në Hagë nën mbrojtje të identitetit, urdhrin për angazhimin e njësisë e ka dhënë komandanti i batalionit, Stevo Kopanja, duke thënë se të gjithë shqiptarët duhej të dërgoheshin drejt fshatit Korenicë, ku po i prisnin pjesëtarët e Ministrisë së Punëve të Brendshme me një “listë terroristësh”. Sipas Fondit, Kaponja ka dalë në pension në vitin 2013, ndërsa Antiq në vitin 2002.

### Roli i policisë speciale dhe formacioneve paraushtarake

Aktakuza e Kosovës përfshin edhe anëtarë të Njërive Speciale të Policisë dhe Njësisë së Operacioneve Speciale, të kryesuar nga Franko Simatoviq. Edhe ai gjendet në Serbi, pasi Tribunali i Hagës e kishte liruar para kohe në vitin 2023, për shkak të shëndetit të dobët. Ai kishte vuajtur tetë vjet e gjysmë nga një dënim prej 15 vjetësh burgim, për krimet e kryera gjatë luftërave në Bosnje dhe Hercegovinë dhe në Kroaci, gjatë viteve '90. Për krimet në Kosovë nuk është mbajtur përgjegjës.

### Asnjë përgjigje nga institucionet në Serbi

Ministria e Mbrojtjes e Serbisë refuzoi t'i sigurojë “Radios Evropa e Lirë” të dhëna për ushtarët e saj që janë në aktakuzën e Kosovës, duke u arsyetuar se Drejtoria Operative e Shtabit të Përgjithshëm “nuk posedon informacionet e kërkuara”. Deri në publikimin e këtij artikulli kjo ministri nuk i është përgjigjur kërkesës së “Radios Evropa e Lirë” për qasje të lirë në informacione me rëndësi publike, edhe pse afati ligjor ka skaduar. “Radio Evropa e Lirë” ka pyetur edhe Zyrën e Prokurorit për Krime Lufte në Serbi nëse, pas nisjes së gjykimit në Kosovë, do të nisë hetime dhe do të bashkëpunojë me Prishtinën, por nuk mori përgjigje. Ngjashëm, as Ministria e Drejtësisë e Serbisë nuk i është përgjigjur pyetjes në lidhje me Marrëveshjen për Ndhimë të Ndërsjellë Juridike. Kjo marrëveshje, e cila ishte arritur në Bruksel në vitin 2013, përcakton që Kosova dhe Serbia të shkëmbejnë kërkesa gjyqësore përmes përfaqësuesve të Bashkimit Evropian. Qeveria e Serbisë, e cila nuk e njeh Kosovën dhe institucionet e saj, nuk ka komentuar publikisht për fillimin e gjyqit në Prishtinë. Pyetjeve të “Radios Evropa e Lirë” nuk i është përgjigjur as Zyra e Presidentit të Serbisë, Qeveria e Serbisë dhe Zyra e saj për Kosovën.

# BAJRAMI: ENERGJIA U 'LIBERALIZUA', FITIMET SHKOJNË TE VUK HAMOVIQI

PRISHTINË, 22 KORRIK - Deputetja e LDK-së, Hykmete Bajrami, ka reaguar ashpër lidhur me procesin e liberalizimit të tregut të energjisë, duke e cilësuar të dhunshëm përjashtimin e mbi 1 300 kompanive nga shërbimi universal i furnizimit me energji elektrike. Ajo ka thënë se ky veprim është kundërshtuar që në fillim për arsye se nuk ekziston treg i lirë funksional dhe se institucionet nuk janë të përgatitura për një hap të tillë. "E kemi kundërshtuar daljen në treg të lirë në mënyrë të dhunshme të rreth 1300 kompanive, ose më saktë, përjashtimin e tyre nga shërbimi universal i furnizimit me energji elektrike, sepse e kemi ditur që, e para, s'ka treg të lirë, dhe e dyta, që askush nuk është i përgatitur", ka shkruar Bajrami në "Facebook".

Bajrami ka theksuar se deri më sot (e martë) asnjë nga kompanitë që janë përjashtuar nga tregu i rregulluar nuk ka marrë faturën për muajin qershor, duke ngritur pyetje të drejtpërdrejta ndaj institucioneve përgjegjëse. "Sot është data 22 korrik dhe ende asnjë kompani e përjashtuar nga tregu i rregulluar nuk e ka marrë faturën e muajit qershor. Pse? S'po dini si me i faturuar? S'po guxonin me treguar sa shumë është rritur çmimi i energjisë për këto kompani? S'po dini si t'i kamufloni fitimet marramendëse të Vuk Hamoviqit dhe të NOA-s në emër të këtij 'liberalizimi'?", ka shkruar Bajrami. Bajrami ka bërë me dije se Prokuroria Speciale ka filluar hetimet ndaj kompanisë NOA dhe, sipas saj, ato do të shtrihen



edhe ndaj zyrtarëve të tjerë përgjegjës. "Një gjë po ju them: hetimet që Prokuroria Speciale

ka filluar ndaj NOA-s nuk do lënë jashtë asnjërin nga ju, sepse në fund të gjithë

përfundoni te fitimet e majme të Vukit dhe NOA-s", ka shkruar Bajrami.

# INSPEKTORATI: KOMPANIA KU NDODHI AKSIDENTI NË GJAKOVË ISHTE GJOBITUR DY HERË PËR SHKELJE

PRISHTINË, 22 KORRIK - Inspektorati Qendror i Punës ka bërë me dije të martën se hapësira e subjektit ku kanë vdekur dy punëtorë të ndërtimit në Gjakovë një ditë më parë është gjobitur dy herë për shkelje të përsëritura. "Kjo e bën edhe më të papranueshëm faktin që nuk janë ndërmarrë masat e duhura për mbrojtjen e jetës dhe shëndetit të punëtorëve", është thënë në reagimin e Inspektoratit. Autoritetet i kanë ndaluar dy persona më 21 korrik nën dyshimet për kryerje të veprës penale "asgjësimi, dëmtimi ose heqja e pajisjeve mbrojtëse dhe rrezikimi i sigurisë në vendin e punës". Përveç dy të vdekurve në



Gjakovë, të hënën ka vdekur edhe një tjetër punëtor i cili ishte lënduar në një aksident tjetër në vendin e punës në qytetin e Pejës. Sipas Zyrës së Inspektoratit, nga

janari deri më 22 korrik në Kosovë kanë ndodhur 268 aksidente në vendet e punës, e prej tyre shtatë raste kanë përfunduar me fatalitet. "Duke qenë se aksidentet në vendin e

punës përbëjnë një kërcënim serioz për jetën e qytetarëve, bëjmë thirrje publike për të gjithë punëdhënësit, subjektet afariste dhe institucionet relevante që të ndërmarrin masa konkrete dhe të menjëhershme për parandalimin e rreziqeve në vendin e punës, në përputhje me Ligjin për Siguri dhe Shëndet në Punë dhe aktet nënligjore në fuqi", është thënë në reagimin e Inspektoratit. Rizah Plakolli, ushtrues detyre i drejtorit ekzekutiv në Inspektoratin Qendror të Punës, ka thënë përmes reagimit të Inspektoratit Qendror të Punës se ka ndërmarrë hapa konkretë për forcimin e kapaciteteve inspektuese dhe se është në proces të rekrutimit të 59

inspektorëve të rinj. Në të kaluarën, udhëheqës të Bashkimit të Sindikatave të Pavarura të Kosovës (BSPK) kanë shprehur shqetësim për, siç kanë thënë, kushtet e rënda me të cilat përballen punëtorët e ndërtimit në punë. Në Ligjin për Siguri dhe Shëndet në Punë theksohet se siguria, trajnimi i punëtorëve, udhëzimet e duhura për përdorimin dhe mirëmbajtjen e pajisjeve dhe makinerive janë obligime që duhet t'i zbatojë secili punëdhënësi për të punësuarit. Sipas Inspektoratit të Punës, vitin që kemi lënë pas janë regjistruar shtatë raste të vdekjeve në vendet e punës, në vitin 2023, njëmbëdhjetë, ndërsa më 2022 janë regjistruar 15 sosh.

# MUNGOJNË FATURAT, SHOQATA E PRODHUESVE KËRKON PEZULLIMIN E VENDIMIT TË ZRRE-së PËR TARIFAT E REJA TË ENERGJISË

PRISHTINË, 22 KORRIK - Shoqata e Prodhuesve të Kosovës, në kuadër të Lidhjes së Bizneseve të Kosovës, i ka bërë thirrje Zyrës së Rregullatorit për Energji (ZRRë) për ta pezulluar menjëherë vendimin e fundit për tarifën e energjisë elektrike, duke e cilësuar atë si një rrezik serioz për sektorin prodhues të vendit. Kjo shoqatë ka theksuar mungesën e përgatitjes institucionale dhe transparencës në implementimin e vendimit. "Fakti që ende nuk kanë ardhur faturat, tregon qartë se nuk ka pasur as përgatitje minimale për zbatimin e këtij vendimi. Kjo situatë dëshmon mungesën e transparencës, planifikimit dhe

konsultimit me palët e prekura", është thënë në reagimin e Shoqatës së Prodhuesve të Kosovës. Shoqata ka shprehur shqetësimin se ky vendim vjen në një çast tepër të ndjeshëm për industrinë vendore, e cila po përballlet me sfida të shumta ekonomike. "Ky vendim, në një kohë kur bizneset vendore po përballen me rritje të madhe të importeve, rënie të eksportit dhe vështirësi serioze në ruajtjen e tregjeve të BE-së, po shndërrohet në një barrë të papërballueshme për prodhuesit tanë", është thënë në këtë reagim. Sipas kësaj shoqate, rritja e menjëhershme e kostove të energjisë pa paralajmërim dhe pa



asnjë konsultim me sektorin privat mund të ndikojë rëndë në konkurrueshmërinë dhe mbijetesën e ndërmarrjeve vendore. "Rritja e menjëhershme e kostove të energjisë, pa asnjë

paralajmërim apo diskutim me sektorin privat, rrezikon jo vetëm konkurrueshmërinë, por edhe mbijetesën e shumë ndërmarrjeve vendore", është thënë në reagimin e Shoqatës së

Prodhuesve të Kosovës. Shoqata ka kërkuar që ZRRë-ja ta tërheqë menjëherë vendimin dhe të nisë një proces të ri, të planifikuar dhe gjithëpërfshirës. "Kërkojmë nga ZRRë pezullimin e menjëhershëm të vendimit dhe fillimin e një procesi të përgjeshëm, të hapur dhe të planifikuar për një tranzicion të drejtë dhe të qëndrueshëm në fushën e energjisë. Sektori prodhues duhet të trajtohet si partner strategjik, jo si viktimë e politikave të nxituara. Lidhja e Bizneseve të Kosovës do të jetë gjithmonë pranë prodhuesve dhe bizneseve, në shërbim të zhvillimit ekonomik të Republikës së Kosovës", është thënë në reagim.

# PO SHUHEMI NGADALË, NGA URIA DHE POSHTËRIMI



Nga Kholoud JARADA\*

Kanë qenë ditët më të këqija nga 652 ditët që kemi përjetuar që kur filluan gjenocidi dhe dëbimi me forcë. Pa përmendur shpërthimet e tmerrshme që vazhdojnë të shkatërrojnë atë që ka mbetur nga Gaza, apo urdhrat poshtërues të evakuimit, nuk mund të mos flas për urinë: uria është bërë arma më vdekjeprurëse që po përdoret kundër nesh. Për muaj të tërë kemi tentuar të qëndrojmë, por tani jemi të kequshqyer dhe të dobët dhe, me përkeqësimin e situatës, nuk jemi më në gjendje të përballojmë ditë të tëra pa ngrënë. Prej javësh, askush në

Gaza nuk është ndier i ngopur, qoftë edhe pak. Kur ecën rrugëve, është e pamundur të mos shohësh sa të rraskapitur dhe të lodhur janë të gjithë. Efektet e urisë lexohen në fytyrat tona të gërryera dhe në trupat tanë të tretur. Vazhdoj të vëzhgoj njerëzit përreth – në punë, në spitale, në rrugë, në shtëpi – dhe pa pasur nevojë të pyes, e di që uria po i përvëlton përbrenda. E ndiej brenda vetes, ashtu sikurse tek secili që më rrethon. Në këtë moment, është e vetmja ndjesi që kemi. Njerëzve po u bie të fikët në rrugë, spitale – përveç të plagosurve – po mbushen me të kequshqyer. Shumë kanë vdekur nga hipoglicemia, kur një lugë sheqer ose një gllënjë

lëng frutash do t'i kishte shpëtuar. Dhe nuk mund të bëjmë asgjë. Mjekët që përpiqen t'i kurojnë, janë edhe vetë të uritur. Edhe gazetarët që raportojnë për këtë uri, po vdesin nga uria. Deri tani, kequshqyerja ka vrarë 76 fëmijë, dhe rreth 600 mijë të tjerë janë në rrezik vdekjeje të afërt, për të njëjtën arsye. Shumë prej tyre tashmë janë të shtruar, por spitale nuk kanë mjete bazike për t'i shpëtuar. Prindërit dhe mjekët nuk mund të bëjnë gjë tjetër veçse t'i shohin duke u shuar. A mund ta imagjinoni një situatë të tillë pafuqie dhe dhimbjeje nga ana e nënave dhe baballarëve që kanë hequr dorë nga racioni i tyre ushqimor për të provuar –

më kot – t'i shpëtojnë? Shumë fëmijë tani ndihen në faj kur thonë “kam uri”: e dinë që vetëm prindërit e tyre do të vuajnë më tej. Tregjet tashmë janë bosh, nuk gjendet më asgjë, as me çmime të shfrenuara. Edhe nëse ke para, nuk mund të blesh dot asgjë, sepse nuk ka çfarë të blesh. Kjo nuk është varfëri, nuk është mungesë burimesh: kjo është uri e qëllimshme dhe e organizuar. Është një armë lufte. Qindra kamionë me ndihma dhe ushqime janë bllokuar në kufi. Mjafton të vendoset t'u lejohet hyrja. Ata pak që arrijnë të hyjnë nuk mjaftojnë. Deri tani të paktën 995 persona kanë vdekur dhe 6.000 janë plagosur, ndërkohë që përpiqeshin të

merrnin ndihma. Çdo mëngjes në familjen time fillon një diskutim i pafund, se si do t'ia dalim të mbijetojmë gjatë ditës. Nuk hamë mish, pulë, vezë, fruta të thata apo bulmet që nga shkurti. Vëllai im endet rrugëve duke kërkuar diçka për të blerë. Kur gjen ndonjë ushqim të pashijshëm dhe të pamjaftueshëm, unë ndiej fajin që më kafshon stomakun me çdo kafshatë, duke ditur që shumë të tjerë nuk mund të përballojnë as një gllënjë ujë. Gjëja më e tmerrshme e urisë është, se sa poshtëruese është. Ja ku jemi: po vdesim ngadalë, ndërsa bota sheh dhe lejon që e gjithë kjo të ndodhë.

Mjeke interniste, 24 vjeç, jeton në Gaza City



## Malisheva liron nga detyra Bekim Isufin dhe komplet stafin e trajnerëve

**MALISHEVË, 22 KORRIK -** FC Malisheva ka ndërprerë bashkëpunimin me kryetrajnerin Bekim Isufi, trajnerin kondicional Arsim

Tershani, trajnerin e portierëve Diamant Kadriolli dhe videoanalistin Shkumbin Gërguri. Klubi malishevas ka shprehur mirënjohje të thellë

për punën dhe përkushtimin e kryetrajnerit Isufi, i cili gjatë një viti me FC Malisheva kontribuoi ndjeshëm në sukseset e

klubit, duke siguruar pjesëmarrjen në garat e UEFA Conference League dhe duke shkruar historinë për herë të dytë radhazi si klub. Ky klub

ka bërë me dije se në ditët në vazhdim do ta bëjë emërimin e kryetrajnerit të ri dhe kompletimin e shtabit teknik.

# XHAKA I THOTË ‘PO’ SUNDERLANDIT, PRITET MIRATIMI I LEVERKUSENIT



**SUNDERLAND, 22 KORRIK (ER) -** Sunderlandi është shumë pranë transferimit të Granit Xhakës nga Bayer Leverkuseni. 32-vjeçari ka edhe tri vjet kontratë të mbetura me klubin gjerman, por është i vendosur të rikthehet në Premierë Ligë dhe t'i bashkohet skuadrës së sapopromovuar angleze. Xhaka, i cili ka 137 ndeshje me Zvicrën dhe fitoi titullin e Bundesligës me Leverkusenin, ka pranuar kushte personale për një kontratë trevjeçare me Sunderlandin. Agjenti i tij, Jose Noguera, ka konfirmuar për Sky

në Gjermani: “Kemi arritur një marrëveshje paraprake me Sunderlandin. Graniti dëshiron të rikthehet në Premierë Ligë. Sunderlandi e emocionon, ai dëshiron ta marrë këtë sfidë. Shpresojmë që Leverkuseni do ta respektojë dëshirën e tij për t'u larguar dhe që klubet do të gjejnë shpejt një marrëveshje”. Sunderlandi ka shpenzuar tashmë 95 milionë funte këtë verë për gjashtë përforcime, përfshirë edhe transferimin e Simon Adingra nga Brighton, por ardhja e Xhakës do të ishte një goditje e madhe. Nga ana

tjetër, drejtuesit e Bayer Leverkusenit nuk e kanë fshehur vlerësimin për Xhakën. Administratori i deleguar i klubit gjerman, Fernando Carro, deklaroi në një intervistë për “Welt”: “Graniti është një lojtar shumë i rëndësishëm për ne si në fushë ashtu edhe jashtë saj. Është lider i skuadrës dhe ka edhe tre vjet kontratë me klubin. Qëllimi ynë është ta mbajmë. Vetëm nëse vjen një ofertë që është e favorshme për të dyja palët, do të ulemi dhe do ta diskutojmë. Për momentin supozojmë që Graniti do të qëndrojë”.

### SHKURT

#### Kosova U19 fillon grumbullimin e radhës, tri miqësore me Kuvajtin

Përfaqësuesja U19 e Kosovës në hendboll ka nisur sot grumbullimin e radhës në kuadër të përgatitjeve për Kampionat Botëror. Kosova është grumbulluar në Prishtinë, ku do të qëndrojë derisa të udhëtojnë për në Slloveni. Në qytetin slloven Velenje, djemtë tanë do t'i zhvillojnë tri ndeshje kontrolluese me Kuvajtin U19. Miqësorja e parë është më 25 korrik, e dyta më 27 dhe e treta më 29 korrik. Këto miqësore i shërbejnë kryetrajnerit Fatmir Muhaxheri dhe shtabit teknik për përgatitje sa më të mirë të ekipit për Botëror. Forma e lojtarëve është e mirë, ndërsa përkushtimi i djemve tanë maksimal.

#### Jashari rikthehet në stërvitje te Club Brugge, por e ardhmja e tij mbetet e paqartë

Mesfushori Ardon Jashari është rikthyer në stërvitje te Club Brugge, raportojnë mediumet belge të martën. Megjithatë, 22-vjeçari po punon veçmas nga ekipi, me një program të personalizuar fizik për ta ruajtur formën në pritje të zhvillimeve rreth së ardhmes së tij. Jashari i ka bërë të qartë klubit belg dëshirën për t'u transferuar te Milani në Serinë A. Negociatat mes klubeve janë në vazhdim, por një marrëveshje ende nuk është arritur. Jashari ka kontratë me Bruggen deri në verën e vitit 2029, pasi iu bashkua verën e kaluar nga Luzerni.

#### Mulleri vazhdon karrierën në MLS

Ylli gjerman i futbollit, Thomas Muller, është pranë një transferimi të bujshëm në Major League Soccer, me Los Angeles FC, që kryeson garën për shërbimet e tij. Pas një karriere të lavdishme me Bayern Munich, ku luajti mbi 750 ndeshje dhe fitoi 13 tituj të Bundesligës, gjermani pritet të nisë një kapitull të ri në ShBA. Megjithëse disa klube nga MLS si San Diego FC, FC Dallas dhe FC Cincinnati shfaqën interes për të, duket se Los Angeles FC janë më pranë sigurimit të firmës së gjermanit. Lëvizja e Mullerit vjen përpara Kupës së Botës 2026 dhe do ta vendosë atë në shoqërinë e yjeve si Messi dhe Suarez që tashmë luajnë në MLS.

## Futbollisti i ri i Vëllaznimit, Dardan Jashari: Do të rikthehi në Superligë

**GJAKOVË, 22 KORRIK (ER) -** Skuadra e Vëllaznimit është përforcuar me mbrojtësin e njohur Dardan Jashari. Klubi kuqezi beson se përvoja dhe lidhshipi i tij do të jenë një përparësi e madhe për ekipin në sezonin e ri. “Dardan Jashari vjen si përforcim i ri për repartin defensiv të Vëllaznimit. Me lidhshipi dhe

vizion të qartë në fushë, ai është i gatshëm ta japë maksimumin”, thuhet në njoftimin e klubit nga Gjakova. Pas zyrtarizmit të marrëveshjes, ka reaguar edhe vetë futbollisti, duke shprehur entuziazmin për këtë hap në karrierë. “Sot, me shumë krenari, ju njoftoj se jam zyrtarisht pjesë e një skuadre me histori të madhe - KF

Vëllaznimi. Është nder ta vesh fanellën kuqezi, të një klubi me traditë dhe pasion të jashtëzakonshëm për futbollin. Do ta jap maksimumin tim në Ligën e Parë, me një synim të vetëm: ta rikthejmë Vëllazninin aty ku e ka vendin - në Superligë! Forca Vëllaznimi, na priftë e mbara!”, ka thënë Jashari.



## Venus Williamsi e përjetshme: Ikona e tenisit rikthehet në fushë dhe fiton në moshën 45-vjeçare

Venus Williams u rikthye të luajë një ndeshje tenisi pas një pauze 16-mujore gjatë së cilës iu nënshtrua një operacioni në mitër. Ajo u rikthye me një fitore në dyshe në turneun WTA Open në Uashington. Amerikanja 45-vjeçare kishte si partnere bashkatdhetaren Hailey Baptiste. Në këtë ndeshje ato mposhtën kanadezen Eugenie

Bouchard dhe amerikanen Clervie Ngounoue me rezultatin 2-0 (6-3, 6-1) në raundin e dytë. “Është ndoshta edhe më e vështirë të luash këtë ndeshje menjëherë pas kthimit sepse nuk jam lojtare e lojës dyshe”, ka thënë Venus Williams, fituese gjashtë herë e grand slam dhe ish-numri 1 në botë në tenisn e femrave. “Kam rifituar

besimin me topin dhe është thjesht mirë të jem në gjendje të luaj. Vetëm mendoni se një vit më parë po përgatitesha për operacion dhe tani po përgatitem për ndeshjen”, ka shtuar ajo. “Dua vetëm të jem e shëndetshme. Mund të luash të gjitha ndeshjet në botë, mund të bësh të gjitha gjërat në botë, por kur shëndeti yt zhduket ose kur

mundësitë të hiqen, perspektiva jote ndryshon plotësisht. As nuk po mendoja për tenisn kur bëra operacionin. Tenisi është një sport, është jeta jonë, fjalë për fjalë obsesioni ynë. Në fakt, është një kult mendoj. Kjo ma bëri më të lehtë vendimin për t’u kthyer këtu dhe ndoshta të luaja edhe më lirshëm”, ka deklaruar Williamsi.



## Fury: Jam i vetmi që e kam mposhtur dhe mund ta mposht Usykun

LONDËR, 22 KORRIK - Boksieri britanik Tyson Fury, ish-kampion bote në peshën e rëndë, thotë se është i vetmi njeri që mund t’i japë fund mbretërimit të Oleksandr Usykut. Ukrainasi u shpall së fundi për të dytën herë si kampion i padiskutueshëm i këtij Divizioni, pas fitores me KO në “Wembley” ndaj Daniel Dubois. Fury ka pësuar dy humbje me pikë ndaj Usykut të cilat ende vihen në dyshim nga ylli britanik, i cili mbetet i sigurt se mund ta rrëzojë 38-vjeçarin e pamposhtur. Në një postim të mbushur me fjalë të ashpra në “Instagram”, Fury ka thënë: “Një përshëndetje e madhe për Oleksandr Usykun. Ai bëri një performancë fantastike ndaj Daniel Dubois, një djalos i mirë, i ri, i cili erdhi për një ndeshje të mirë. Urime të dyve, por Usyk e di se ka vetëm një njeri që mund ta mposhtë atë.



Unë e kam bërë dy herë më parë dhe bota e di këtë”. Fury u tërhoq nga sporti pas humbjes në ndeshjen e kthimit, në dhjetor ndaj Usykut, por 36-vjeçari ka vijuar stërvitjen dhe është gati për rikthim. Kohët e fundit ka postuar pamje të vetes përsëri në palestër me trajnerin SugarHill Steward në

formë dhe gati për të dueluar. “Jam duke vrapuar në rrugë. U ktheva në shtëpi. E bëra punën time dhe e mora veten përsëri. Unë jam burri. Unë jam spartani. Pavarësisht se çfarë do të thotë dikush, unë i fitova ato ndeshje, të garantuara, 100 %”, ka deklaruar Fury.

## Antonelli: Formula 1 si një det me peshkaqenë, mund të “të hanë” në çdo çast

BOLOGNA, 22 KORRIK - Sezoni i parë në Formula 1 për pilotin e ri italian Kimi Antonelli ka qenë me ulje-ngritje. Në 12 garat e para me makinën Mercedes ai ka korrur një podium (në Kanada), por në paraqitjet e fundit ka pasur shumë zero për shkak të tërheqjeve, problemeve apo aksidenteve. Ulje dhe ngritje, të natyrshme për një fillestar, çaste që demonstrojnë rëndësinë e familjes, lidhjeve dhe gjithçkaje që mund ta normalizojë jetën dhe emocionet e një 18-vjeçari i cili edhe mund të mbingarkohet nga bota e Formulës 1. Vetë Antonelli e përjetoi këtë presion në Imola, ku mësoi të gjente kohë për veten. “Në Formula 1 është si të notosh në një det plot me peshkaqenë; mund të biesh në kurrth dhe të të hanë në një çast. E kuptova këtë



në Imola. Atje kuptova sa e rëndësishme është të gjej kohë për veten, momente ku mund të jem vetëm në një vend të qetë, ku mund të izoloheh”, ka thënë piloti i Mercedesit. “Në karrocërinë e inxhinierëve ka një dhomë të rezervuar për pilotët. Shkoj atje

para se të hipi në makinë, vizualizoj dhe riluaj xhirot e pistës në kokën time dhe, për ta bërë këtë, duhet të jem i qetë. Më parë nuk u kushtoja vëmendje këtyre aspekteve, por tani i konsideroj thelbësore për të dhënë 110 %”, ka shtuar Antonelli.

### SHKURT

#### Fiorentina heq dorë nga Asllani

Mesfushori i Kombëtares shqiptare, Kristjan Asllani, është jashtë planeve të Interit dhe kjo është pranuar publikisht edhe nga drejtuesit e zikaltërve, por ata nuk po bëjnë asgjë që ta ndihmojnë mesfushorin që të gjejë një sistemim të ri. Pasi Asllani refuzoi Betisin, sepse dëshiron të vazhdojë të luajë në Serinë A, u përfol se dy skuadra kishin mbetur në garë për të, të interesuara për t’i siguruar shërbimet e mesfushorit kuqezi. Fiorentina dhe Bologna janë në kërkim të përforcimeve në mesfushë dhe shohin tek Asllani një element që mund t’i ndihmojë të bëjnë një tjetër hap cilësor. Por mediet italiane raportojnë se Fiorentina është tërhequr nga interesimi për futbollistin për shkak të çmimit të lartë që Interi i ka vendosur kartonit të tij. Zikaltrit kërkojnë 18-20 milionë euro për ta lënë të lirë futbollistin e Kombëtares dhe në Itali kjo shifër nuk paguhet lehtësisht. Ndaj klubi i qytetit të Firences është tërhequr dhe tashmë është një opsion më pak për të ardhmen e Asllanit.

#### Amar Gërxhaliu paraqitet te Erzurumspor

Futbollisti nga Kosova, Amar Gërxhaliu, tashmë edhe zyrtarisht është bërë me ekip të ri. Gërxhaliu është bërë pjesë e Erzurumsporit, që bën gara në kategorinë e dytë të futbollit turk. Lajmin për transferimin e 23-vjeçarit e dha faja zyrtare e klubit turk përmes një video të publikuar në “Instagram”. Kujtojmë se Gërxhaliu ishte futbollist i lirë në treg pas skadimit të kontratës me Antalyasporit dhe kështu i është bashkuar Erzurumsporit si lojtar i lirë. Ai kishte marrë ftesë nga Kosova në vitin 2023 nga përzgjedhësi i atëhershëm Alain Giresse për dy ndeshjet kualifikuese për Euro 2024 ndaj Izraelit dhe Andorrës. Më 15 shtator 2022 Gërxhaliu mori thirrje nga Kosova U21 për një kamp stërvitor të mbajtur në Antalia të Turqisë dhe luajti një ndeshje miqësore kundër Grenlandës.

#### Unitedi zyrtarizon transferimin e Mbeumos

Manchester Unitedi ka siguruar shërbimet e Bryan Mbeumos. Lajmi është bërë publik nga klubi nëpërmjet një postimi në rrjetet sociale. Mbeumo ka firmosur një kontratë për pesë vjet, me operacionin në total që kap shifrën e 71 milionë eurove. Sulmuesi vjen nga Brentfordi, teksa në sezonin e fundit në kampionat ai realizoi 20 gola dhe dhuroi 7 asistime. Transferimi i tij në Manchester ka qenë dëshirë e drejtpërdrejtë e trajnerit të “Djajve të kuq”, Amorim.

#### Retegui transferohet për 65 milionë euro në Arabinë Saudite

Sulmuesi italian Mateo Retegui është larguar nga Seria A për ta vazhduar karrierën në Lindjen e Mesme. Retegui është transferuar tek ekipi i Arabisë Saudite, Al Qadsiah nga Atlanta për 65 milionë euro, duke u bërë lojtari më i shtrenjtë i Italisë. Retegui vetëm sezonin e shkuar ishte pjesë e Atalantas, ndërsa në Itali ka bërë karrierë edhe te skuadra e Genoas, ku në total ka shënuar 32 gola në 65 paraqitje në Serinë A. 26-vjeçari si futbollist është zhvilluar në Argjentinë, ndërsa për Kombëtaren e Italisë ka shënuar 6 gola në 20 paraqitje prej vitit 2023.

## Napoli dëshiron edhe Chiesan dhe Grealishin

Pas disa afrimeve mjaft të mira, Napoli po mendon për përforcime të reja. Sipas “La Gazzetta dello Sport”, objektivat janë Federico

Chiesa dhe Jack Grealish. Sulmuesi Grealish është jashtë projektit të Manchester Cityt, me Pep Guardiolen që nuk do të llogarisë në shërbimet e tij

për sezonin e ri. Së fundmi ka pasur kontakte me napoletanët dhe nuk përjashtohet mundësia që lojtari të transferohet te

kampionët e Italisë. Ndërkohë Chiesa numëron vetëm 14 paraqitje këtë sezon për Liverpoolin dhe nuk u thirr nga Arne Slot për turneun e

“The Reds” në Azi. Ky është një sinjal i fortë, që tregon se Chiesa me gjasë do të ndërrojë mjedis dhe Napoli mbetet një destinacion i mundur.





ROYAL CROWN

**RC**  
cola

# ANNOUNCING THE 2017 QUALITY & SALES AWARDS

## Quality & Sales Award Recipients

[Listed in alphabetical order]

- ★ ARC Refreshments Corporation- Antipolo **Philippines**, Quality
- ★ Embotelladora Central S.A **Paraguay**, Quality
- ★ Fabrica de Bebidas Gaseosas Salvavidas S.A. **Guatemala**, Quality
- ★ Fluidi Sh.p.k. **Kosovo**, Quality
- ★ Indústria e Comércio de Bebidas Funada Ltda **Brazil**, Quality
- ★ Interbrand S.A.L. **Lebanon**, Sales
- ★ Kofola ČeskoSlovensko a.s. **Czech Republic**, Quality
- ★ Obi Zulol CJSC **Tajikistan**, Quality
- ★ Partex Sales sales Beverages Ltd. **Bangladesh**, Quality
- ★ Soft Drinks Georgia **Georgia**, Sales

Columbus, Georgia, USA  
Since 1906

Columbus, Georgia, USA  
Since 1906 0.5L

**MEKA**  
HALAL FOOD

# TRADITË QË NGA 1992

